



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 691/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Kujtim Kallaba, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Kujtim Kallaba, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, me shenjën ZL.Anr.691/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017 në ora 14:30, nga Kujtim Kallaba, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë me të cilën pretendon se me rastin e publikimit të rezultateve në vendvotimin me Nr. 1024D/01R, 02R, 03R, 04R, nuk mu janë numëruar drejtë votat për kandidatë për asamblë komunale, prandaj PZAP-it i ka kërkuar rinumërim të votave me nr.5 në të gjitha njësitet e vendvotimeve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet Nr. 1024D/01R, 02R, 03R, 04R në fshatin në fshatin

Koretin në Kamenicë si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.691/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Gyltëne Sylejmani

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orësh nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

